



KOMUNA VUSHTRRI

MARRËVESHJE MIRËKUPTIMI
PËR TRAJTIMIN E QENVE ENDACAK NË KOMUNËN E VUSHTRRISE

Palët Nënshkruese:

1. Komuna e Vushtrrisë përfaqësuar nga **z. Xhafer Tahiri**, Kryetar i Komunës (në tekstin e mëtejme Komuna)
2. Fondacioni StrayCoCo / Stiftung Steinbüelweg 8, CH-8332 Russikon nga Zvicra, përfaqësuar nga **Znj. Helen Worms** (në tekstin e mëtejme fondacioni)

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i lidhjes së kësaj marrëveshje është realizimi i projektit për trajtimin human të qenve endacak në territorin e Komunës së Vushtrrisë e që për impakt do të ketë zvogëlimin e numrit të tyre, me qëllim të evitimit të rreziqeve të shëndetit dhe jetës së qytetarëve. Me këtë projekt gjithashtu arrihet qëllimi i parandalimit të përhapjes së sëmundjeve infektive zoonozave, Tërbimit me anë të vaksinimit dhe ekinokokoze me tableta.

Neni 2
Financimi i Projektit

Komuna e Vushtrrisë dhe Fondacioni StrayCoCo / Stiftung Steinbüelweg dakordohen që të bashkë financojnë realizimin e këtij projekti në mënyrën dhe kushtet e përcaktuara në këtë marrëveshje.

Neni 3
Kohëzgjatja e Marrëveshjes

Marrëveshja lidhet në afat kohorë prej 01.09.2020 deri më 28.02.2022.

Neni 4
Lokacioni dhe trajtimi

Trajtimi i qenve endacak sipas kësaj marrëveshje bëhet nga stafi profesionist i veterinarisë i Ambulancës Veterinare të cilën e përzgjedhë Fondacioni StrayCoCo / Stiftung Steinbüelweg.

Neni 5

Obligimet e Përbashkëta të Palëve

Komuna e Vushtrrisë dhe Fondacioni StrayCoCo do ti mbulojnë shpenzimet e trajtimit veterinar, përfshirë kastrimin/ sterilizimin për 500 qenë endacak, brenda afatit prej 18 (tetëmbëdhjetë) muaj sa do të zgjas kjo marrëveshje. Në kuadër të këtij numri të qeneve të trajtuar përfshihen edhe rastet e eutanazisë.

Neni 6

Obligimet e Komunës së Vushtrrisë

- 6.1 Komuna e Vushtrrisë do të participoj nga buxheti i saj për shërbimet veterinare që do të kryhen për qenë endacak, në bazë të çmimeve të përcaktuar në nenin 8 të kësaj marrëveshje.
- 6.2 Komuna e Vushtrrisë do të i inkurajojë qytetarët, pronarët e qenve që nuk kanë mundësi pagese për një konsultë veterinare për ti sjellë qentë e tyre, veçanërisht qentë femra, në Ambulancën Veterinare të cilën e përzgjedhë Fondacioni StrayCoCo / Stiftung Steinbwelweg, për sterilizim, vaksinim dhe dhënien e tabletave antiparazit falas nga Fondacioni.
- 6.3 Komuna e Vushtrrisë do të organizojë fushatë informuese të qytetarëve në lidhje me programin e Sterilizimit dhe kastrimit në vazhdim.

Neni 7

Obligimet e Fondacioni StrayCoCo / Stiftung Steinbwelweg

Fondacioni StrayCoCo / Stiftung Steinbwelweg merr për obligim që nga stafi veterinar i Ambulancës Veterinare të cilën e përzgjedhë, të i kryej këto shërbime veterinare:

- 7.1 Kapjen e qenve endacakë
- 7.2 Trajtimin (kontroll, ushqim, vaksinim, dehelmentizim, identifikim, matrikul)
- 7.3 Kastrimi/sterilizim
- 7.4 Hospitalizimi (3 ditë tek meshkujt dhe 5 ditë tek femrat)
- 7.5 Vaksinimi i qenve me dy Vaksina, vaksinë polivalente dhe vaksinë kundër Tërbimit (rabies)
- 7.6 Tableta antiparazit për 500 qenë
- 7.7 Lëshimi ne vendin e kapjes
- 7.8 Eutanazia për qentë e sëmurë dhe agresive (kryerja e procesit te eutanazisë),
- 7.9 Ambulanca Veterinare që e përzgjedhë fondacioni, kontrollon dhe monitoron çdo qen endacak i cili duhet të ketë të dukshëm matrikulën në vesh që është i identifikuar dhe regjistruar se qeni është sterilizuar dhe vaksinuar dhe trajtuar siç duhet.
- 7.10 Çdo qen regjistrohet në një regjistër së bashku me një fotografi me matrikulë në vesh, me numër të dukshëm . Ky Regjistër i kontrollit rregullisht do të ju prezantohet fondacionit StrayCoCo dhe Komunës.

Neni 8

Kostoja financiare – çmimet e trajtimit

- 8.1 Në realizimin e këtij projekti Fondacioni Straycoco merr pjesë me mjete financiare prej 54 % ndërsa komuna e Vushtrrisë me 46 %.

8.2 Kostoja për këtë trajtim për secilin qenë është 60.00 € (gjashtëdhjetë euro). Fondacioni StrayCoCo do të mbulojë koston për 33.00 € (tridhjetë euro) dhe pjesa tjetër prej 27.00 € (njëzetë e shtatë) euro do të mbulohet nga Komuna e Vushtrrisë.

8.3 Për rastet e Eutanazisë do të paguhet 10 euro nga komuna dhe pjesa tjetër prej 10 euro nga fondacioni Straycoco.

8.4 Përshkrimi dhe çmimet për shërbimet veterinarë që do të kryhen paraqitur në formë tabelare:

Nr.	Përshkrimi i shërbimit veterinar	Njësia	Çmimet	Pagesa kryhet nga:
1	Zënia/kapja e qenve endacak dhe vlersimi për gjendjen shëndetësore .	Krerë/copë	10.00€	Komuna
2	Kastrimi/Sterilizimi i qenve endacak.	Krerë/copë	33.00€	Fondacioni StrayCoCo
3	Trajtimi (kontroll,ushqim) identifikim i qenve endacak-matrikuj, vaksinim Hospitalizim (3 ditë meshkujve dhe 5 dite femrave) dhe Lëshimi i qenve endacak në vendin e zënies-kapjes.	Krerë/copë	17.00€	Komuna
4	Total		60.00€	./...

8.5 StrayCoCo zotohet se qentë me lëndime trupore si: këmbë të thyera, plagë ose me zgjebe, do të trajtohen, do të hospitalizohen deri në shërimin e tyre. Shpenzimet për trajtim dhe hospitalizimin e këtyre rasteve i mbulon fondacioni StrayCoco.

Neni 9

Pagesa për shërbimet e kryera

Komuna do të kryej pagesat për shërbimet veterinarë të kryera sipas kësaj marrëveshje në baza tre mujore, pas dorëzimit të faturës bashkë me raportin me shkrim të nënshkruar nga mbikëqyrësi i komunës. Pagesa e parë do të bëhet me lejimin e buxhetit në fillim të vitit 2021.

Neni 10

Ndryshimet dhe ndërprerja e marrëveshjes së mirëkuptimit

10.1 Me pëlqimin paraprak të palëve nënshkruese kjo Marrëveshje e Mirëkuptimit mund të ndryshohet dhe plotësohet.

10.2 Komuna mban të drejtën e ndërprerjes së pagesës së shërbimeve për këtë destinim në rast se konstaton se fondacioni StrayCoCo nuk i përmbushë obligimet e veta nga kjo marrëveshje.

Neni 11

Mbikëqyrja e Zbatimit të Marrëveshjes

Mbikëqyrjen e zbatimit të kësaj marrëveshje nga komuna do ta bëjë një zyrtar i komunës i cili do të caktohet me vendim të Kryetarit të Komunës, ndërsa nga pala tjetër përfaqësuesi caktuar prej saj.

Neni 12

Zgjidhja e mosmarrëveshjes

Palët pajtohen që mosmarrëveshjet eventuale të i zgjidhin me mirëkuptim, të kundërtën çështja do të kalohet në Gjykatën kompetente.

Neni 13
Numri i ekzemplarëve

Marrëveshja e mirëkuptimit është përpiluar dhe nënshkruar në tre ekzemplar në origjinal, prej të cilëve dy për komunën dhe një për palën tjetër nënshkruese. Marrëveshja përmban 14 nene në katër (4) faqe A/4.

Neni 14
Hyrja në fuqi

Kjo marrëveshje të hyj në fuqi në ditën e nënshkrimit ndërsa dot fillon të zbatohet nga data 01.09.2020.

Vushtrri, më; _____ 2020


Komuna Vushtrri

z. Xhafer Tahiri, Kryetar

Fondacioni StrayCoCo / Stiftung Steinbüelweg

Dr. Helen Worms